



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:219382

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05610358

CP.nr.1053/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, si me gjyqtarin individual Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përbarimore të kreditorëve N. D., N. Z., H. M., S. R., L. M., I. H., H.B., G. B., S. S., N. U., te cilët i përfaqëson me autorizim avokat Sheremet Ademi me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përbarimor - Aktgjykimi C.nr. 530/2019, te datës 04.06.2021, të lejuar me aktvendimin për përbarim CP 1052/21, te datës 09.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 23.04.2024 morri këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e udhëhequr sipas shenjës CP 1053/21, me kreditorë N. D., N. Z., H. M., S. R., L. M., I. H., H.B., G. B., S. S., N. U., ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditorët e përbarimit N. D., N. Z., H. M., S. R., L. M., I. H., H.B., G. B., S. S., N. U., te cilët i përfaqëson me autorizim avokat Sheremet Ademi me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, ka paraqitur propozim për përbarim në bazë të dokumentit përbarimor - Aktgjykimi C.nr. 530/2019, te datës 04.06.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përbarimit, me aktvendimin CP 1052/21, te datës 09.09.2021, ka lejuar përbarimin ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit – Mitrovicë.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 1052/21, te datës 09.09.2021, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt. ..., ka njoftuar gjykatën se debitori i përbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se “*Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore*”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CP.nr.1053/2021 më datë 23.04.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditore nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.